




## Projekti i zhvillimit të kapaciteteve për Kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.1 (Janar 2018)

Republika e Kosovës (këtu e tutje "Kosova") është tërësisht e varur nga linjiti i cilësisë së dobët, të mihur në vend, si burim kryesor i energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes, etj. Për këtë arsye, ndotja e ajrit në zonat urbane është bërë problem serioz mjedisor dhe efekti i saj në shëndetin e njeriut është shqetësim i madh.

Në përgjithësi kontrolli i ndotësve të ajrit përbëhet nga 1) matja e burimeve të emisioneve të ndotësve të ajrit, 2) monitorimi i cilësisë së ajrit dhe 3) vlerësimi i cilësisë së ajrit duke marrë parasysh të dhënat shkencore dhe teknike. Figura e mëposhtme tregon këto aktivitete qeveritare.



Këto aktivitete janë të përfshira në Projektin e JICA-s dhe projekti i JICA-s zhvillohet në zonën e Prishtinës.

Qëllimi i Projektit të JICA-s është përmirësimi i kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (këtu e tutje "MMPH") si dhe organizatave dhe agjencive të saj përkatëse për menaxhimin e ndotësve të dëmshëm të ajrit, duke kontribuar kështu në planifikimin dhe zbatimin e masave më efikase

për zvogëlimin e emisioneve në ajër, për mbrojtjen e shëndetit publik dhe zhvillimin e politikave të lidhura me menaxhimin mjedisor në Kosovë.

Projekti i JICA-s ka filluar në tetor 2017.


Aktivitetet e zhvilluara në dhjetor 2017 kanë qenë shqyrtimi i kontrollit të emisioneve në termocentrale (këtu e tutje "TC") dhe mbledhja e informacionit për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit përmes mbajtjes së seminarit.



Vizitat për hulumtimin në terren të TC-ve



Seminari në MMPH



Takimi Konsultativ në Universitet

Në vitin 2018 do të fillojë aktiviteti për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit.

Përveç kësaj, ekspertët e JICA-s dhe Homologët (kryesisht MMPH-ja) do të kryejnë hulumtime të burimeve të emisionit me mbështetjen e studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Aktiviteti në TC-të gjithashtu do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme duke matur emisionet



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Projekti i zhvillimit të kapaciteteve për Kontrollin e ndotjes  
së ajrit në Republikën e Kosovës

Buletini Nr.1 (Janar 2018)

e gazit nga oxhaku për t'i studiuar masat për  
zvogëlimin e emisioneve.